

Shqiptarët, jo vetëm objekt studimi por edhe studiues

14/11/2010 | Blerim Shabani

Kajtazi: "Shqiptarët e Zvicrës janë parë nga disa si ngarkesë e këtij vendi. Sot ata nuk janë ngarkesa por pesha e këtij vendi"



Të premtën që shkoi është themeluar në Lozanë Instituti Zviceran për Studime Shqiptare (ISEAL). Zhvillimi i lidhjeve ndërmjet Zvicrës dhe shqiptarëve, ndihma për integrimin e shqiptarëve në Zvicër, shndërrimi i ISEAL në një pikë referimi për autoritetet zvicerane dhe ato të shteteve ku jetojnë shqiptarët etj. janë disa nga objektivat e këtij organizmi të ri.

Në mbrëmjen festive të përvitit të institutit, ishin të pranishëm një numër i madh personalitetesh nga politika, kultura dhe nga bota akademike, zvicerane e shqiptare. Krijimin e kësaj themelate të rëndësishme për kulturën tonë në Zvicër, me përgëzimet e tyre dhe zotimin për ndihmë, e përshëndetën disa nga të pranishmit.

Prezantim me vlera

Në emrin e këshillit, i pari mori fjalën Francis Cousin, kryetar i Këshillit të ISEAL, diplomat, ish ambasador i Zvicrës në Shqipëri. Ai vuri theksin në nevojën që komuniteti shqiptar ka për njohjen e tij përmes kulturës dhe për prezantimin e vlerave të tij para shoqërisë vendëse. Këtij qëllimi, sipas Cousin, do t'i shërbejë themelimi i institutit të ri.

Në vazhdim, përshëndetjet e tyre i kanë drejtuar publikut edhe Alexandra Clerc, përfaqësuese nga Enti Federal për Migracion; Magaly Hanselmann, përgjegjëse e kantonit Vaud për integrim të tij huajve dhe për parandalim të racizmit dhe Jean Christophe Burquin, këshilltar komunal i Lozanës.

Po ashtu, me fjalë të zgjedhura bartësit e projektit i kanë përgëzuar edhe Ambasadori i Shqipërisë në Zvicër Mehmet Elezi, ambasadori i Kosovës në Zvicër Naim Malaj dhe ambasadori i Maqedonisë po në këtë shtet, Ramadan Nazifi.



Francis Cousin



Alexandra Clerc



Driton Kajtazi

Projekte të shumta mbi mërgatën shqiptare në Zvicër

Duke marrë fjalën në përmbyllje, drejtori dhe ideatori i ISEAL, Driton Kajtazi ka vënë theksin në misionin që themeluesit i kanë vënë "Institutit...". "Ka kohë që shqiptarët e Zvicrës janë parë nga disa si ngarkesë e këtij vendi. Sot shqiptarët nuk janë ngarkesa por pesha e këtij vendi", ka konstatuar Kajtazi.

Më tutje ai ka shtuar se "me Institutin Zviceran të Studimeve Shqiptare – ISEAL, shqiptarët nuk janë më vetëm objekt i studimeve por edhe studiues". Kajtazi ka premtuar se ISEAL, përmes sektorëve të tij do të zhvillojë shumë projekte me rëndësi. Në mesin e atyre që janë në plan, ai përmendi një studim mbi shqiptarët e Zvicrës, i cili do të publikohet në gjuhën gjermane, frëngje, italiane dhe shqipe.

Atmosferës së mbrëmjes i kontribuuan edhe pikat artistike, të prezantuara nga Ilir Bytyçi që shoqëroi me kitarë recitimin e një poezie të autores zvicerane Anne Perrier nga aktorja Diellza Ismajli. Ndërsa përfund, Gjon Guralumi u paraqit me disa perla të muzikës arbëreshe dhe shqiptare, të interpretuara mjeshtërisht me fizarmonikë. Mbrëmjen e drejtoi Visar Qusaj, kryetar i Shoqatës së Miqve të ISEAL.

<http://www.albinfo.ch/e-diaspora/integrimi/shqiptar%C3%ABt-jo-vet%C3%ABm-objekt-studimi-por-edhe-studiues-4401>